



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet: 198 dhe 200 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 197, 199 dhe 201 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Sigurime Sociale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punës dhe Sigurimeve Sociale.
- Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Amendamentimit Nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2016.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Miratohet Raporti për Vlerësimin *Ex-Post* të Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtje ("Raporti për Vlerësimin *Ex-Post*").
- Obligohet Ministria e Drejtësisë që në procesin e ardhshëm të planifikimit legjislativ të merr parasysh gjetjet dhe rekomandimet e Raportit për Vlerësimin *Ex-Post*.
- Pjesë e këtij Vendimi është Raporti për Vlerësimin *Ex-Post*.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/206
Datë: 21.05.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafit 4. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 2,870,000€ në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZhR) me kod 221, nën-programi Administrata Qendrore me kod 11321, nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale, konkretisht nga projekti "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782 në 25 (njëzet e pesë) projekte kapitale në përputhje me Marrëveshjet e Mirëkuptimit të nënshkruara nga Ministri i MZhR-së dhe Kryetarët e Komunave.
- Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga projekti "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782 në këto projekte, me shumatat e cekura si në vijim:
 - "Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatarrë" në Komunën e Deçanit, në vlerën prej 140,000.00€;
 - "Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe këndin e lojërave për fëmijë" në Komunën e Dragashit, në vlerë prej 55,000.00€;
 - Rregullimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor, biçiklistë në parkun e Kamenicës - Komuna e Drenasit, faza e dytë" në Komunën e Drenasit, në vlerë prej 120,000.00€;
 - "Krijimi i infrastrukturës rekreative - sportive në zonën turistike Neredime - Jezerc" në Komunën e Ferizajit, në vlerë prej 80,000.00€;
 - "Ndërtimi i parkut rekreativ në Sllatinë të Vogël" në Komunën e Fushë Kosovës, në vlerë prej 70,000.00€.
 - "Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë" në Komunën e Gjakovës, në vlerë prej 120,000.00€;
 - Asfaltimi i rrugës "Ekzodi 99" në Komunën e Hanit të Elezit, në vlerë prej 80,000.00€;
 - "Zgjerimi i infrastrukturës në Zonën Ekonomike në Istog" në Komunën e Istogut, në vlerë prej 70,000.00€;
 - "Ndërtimi i objektit kullë për vizitor tek bashkimi i dy lumenjve në Kaçanik" në Komunën e Kaçanikut, në vlerë prej 60,000.00€;
 - "Parku i Aventurave" në Komunën e Kamenicës në vlerë prej 50,000.00€, në kodin e vitit të kaluar v. 2023 (16170);
 - "Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi i Pejë-Prishtinë, faza II" në Komunën e Klinës, në vlerë prej 140,000.00€;
 - "Rregullimi i shtratit të lumit - Morava e Vjetër në Kllokot" në Komunën e Kllokotit, në vlerë prej 150,000.00€;

- 2.13. "Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës për shumë qëllime" në Komunën e Mamushës, në vlerë prej 225,000.00€;
 - 2.14. "Renovimi i Qendrës Multifunktionale" Omni Sport" në Mitrovicë - Lot 1" në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në vlerë prej 150,000.00€;
 - 2.15. "Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Budrig të Parteshit" në Komunën e Parteshit, në vlerë prej 80,00.00€.
 - 2.16. "Asfaltimi i rrugës Llugagji-Jabllanicë e Gjakovës" në Komunën e Pejës, në vlerë prej 120,000.00€;
 - 2.17. "Ndërtimi i Tregut të Gjelbër" në Komunën e Podujevës, në vlerë prej 100,000.00€;
 - 2.18. "Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy faza në Pallatin e Rinisë" në Komunën e Prishtinës, në vlerë prej 120,00.00€;
 - 2.19. "Ndërtimi i objektit Administrativ për nevojat e zejtarëve " ESNAF", në Komunën e Prizrenit, në vlerë prej 160,00.00€;
 - 2.20. "Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit" në Komunën e Rahovecit, në vlerë prej 130,00.00€;
 - 2.21. "Parku i Aventurave Drenovc" në Komunën Ranillugë, në vlerë prej 50,000.00€;
 - 2.22. "Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes (faza II), në Komunën e Shtimes, në vlerë prej 140,000.00€;
 - 2.23. Ndërtimi i çerdhes për fëmijë - vazhdimi i aneksit të dytë" Komuna e Skenderajt, në vlerë prej 210,000.00€;
 - 2.24. "Renovimi i Urës së Tranzitit dhe rregullimi i shtratit të lumit "Tophulla" - Segmenti 2.2" në Komunën e Suharekës, në vlerë prej 130,00.00€;
 - 2.25. "Udha e Gurit" në Komunën e Vushtrrisë, në vlerë prej 120,000.00€.
3. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal për zbatimin e këtij Vendimi.
 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafit 12. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet kërkesa e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 300,000€ (treqind mijë euro), për realizimin e projektit përmes marrëveshjeve me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
- Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Marrëveshjet me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara" me kod 34100, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, me kod 211, në nën-programin "Administrata Qendrore", me kod 11311, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
- Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, për zbatimin e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafit 12. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 200,000€ (dyqind mijë euro), për realizimin e projektit përmes marrëveshjeve me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Marrëveshjet me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara" me kod 34100, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod 205, në nën-programin "Mjedisi" me kod 50100, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafit 8. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Ndahen mjete financiare në shumë prej 100,000 € (njëqind mijë euro) për "The Kosovo American Education Fund", me qëllim të promovimit të vendit.
- Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nën-programi për Promovim të Vendit dhe barten në xhirrollogarinë e "The Kosovo American Education Fund".
- Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

- Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme ish shoqërore P. Sh "Progres" e cila preket nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Qendrës së Paraburgimit dhe Institucionit Korrektues në Prizren" për nevoja të Shërbimit Korrektues të Kosovës/Ministria e Drejtësisë, ZK Dushanovë, Komuna Prizren, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
- Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
- Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
- Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/ Shërbimi Korrektues i Kosovës/Ministria e Drejtësisë.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Ndërtimi i Rrugës Rajonale R221 Cerkoz-Rakosh Zonat Kadastrale: Cerkoz, Rakosh, Suhogërrllë dhe Uçë, Komuna Istog, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
- Vlerësimi i pronave të paluajtshme do të bëhet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
- Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
- Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.12/206
Datë: 21.05.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i Projektit: Konservimi, Restaurimi dhe Ndërtimi i Kompleksit Memorial "Masakra e Reçakut" ZK Reçak, Komuna e Shtimes, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronave të shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjekti Kërkues/Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK).
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK).

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për shpërbërjen vullnetare të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës (NKEC)" Sh. A.
2. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.07/47, i datës 15 maj 2018 për Themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës Sh. A./NKEC.
3. Obligohet Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike të ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, duke përfshirë sidomos njoftimin e shpërbërjes vullnetare dhe veprimet e tjera të parapara me nenin 212 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor për Performancën e Ndërmarrjeve Publike Qendrore për vitin 2022.
2. Raporti nga pika 1. e Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Miratohet Plani i Menaxhimit të Pellgut Lumor Drini i Bardhë.
- Për zbatimin e këtij Plani, obligohen: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komunitat pjesëmarrëse dhe institucionet tjera të përcaktuara në këtë Plan.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/206
Datë: 21.05.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19/A të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i plotësuar dhe ndyshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohen kërkesat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e fondeve të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në katër (4) ndërmarrje shoqërore, si në vijim:
 - N. Sh. "Separacioni i gurëve Gadime", në shumë prej 4,114,05 € (katërmijë e njëqind e katërbëdhjetë euro e pesë cent);
 - N. Sh. "Energomontimi", në shumë prej 106,580,83 € (njëqind e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë euro e tetëdhjetë e tre cent);
 - N. Sh. "Çeliku", në shumë prej 18,223.43 € (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e tre euro e dyzet e tre cent); dhe
 - N. Sh. "KB Baran", në shumë prej 3,051.07 € (tre mijë e pesëdhjetë e një euro e shtatë cent).
- Mjetet buxhetore merren nga kodi i pranimit të këtyre të hyrave dhe nga llogaria kryesore e BRK dhe kthehen në llogaritë e ndërmarrjeve shoqërore sipas pikës 1. të këtij Vendimi, me qëllim që ndërmarrjet shoqërore të kenë mjete të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat kreditore apo për të mbuluar shpenzimet e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
- Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar për programin për "Financat Publike të Kosovës dhe Rritja Ekonomike".
- Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për Programin e Parë për Financimin e Politikave Zhvillimore për Efektivitetin Fiskal, Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Gjelbër në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.05/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisionit ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, në këtë përbërje:
 - Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, kryesuese;
 - Fadile Dyla, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtare;
 - Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, anëtar;
 - Ahmet Gashi, U. D. i Udhëheqësit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
 - Besnik Aliu, ekspert i jashtëm, anëtar.
- Komisioni obligohet që t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij siç parashihet në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë